

**AKT THEMELIMI**  
**Dhe**  
**STATUT**  
**i Shoqërise me Përgjegjësi të Kufizuar**  
**“Opportunity & Co” SHPK**

**KREU I**

**THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**NENI 1:**

**DATA E THEMELIMIT, EMRI DHE THEMELUESIT**

Sot, më 13.12.2021, une themeluesja, hartoj dhe nenshkruaj kete Akt Themelimi dhe Statut per te krijuar dhe rregjistruar kete shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin:

**“Opportunity & Co” SH.P.K.**

**Neni 1**

**THEMELUESI I SHOQËRISË:**

1. **Jerina Kume**, me shtetesi Shqiptare, lindur me 19.01.1990 ne Berat, identifikuar me leternjoftim me nr. personal J05119072V, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

**Neni 2:**

**OBJEKTI**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Konsulencë dhe sherbime financiare per individe dhe persona fizike e juridike vendas e te huaj;  
Konsulencë për investime shqiptare dhe të huaja; Manaxhim Burimesh Njerëzore; Konsulencë Ligjore; Veprimtari ne fushen e pasurive te paluajtshme (Real Estate); Sherbime ne fushen e IT & Inovacionit; Konsulencë karriere (*edukim, trajnime profesionale*); Konsulencë për investime në fushën e energjitikës (fotovoltaik, Eolik, Hidro etj.);nKonsulencë në fushën e emigracionit; Ndërmjetësime tregtare; Konsulencë për financime islamike dhe çertifikime të ndryshme; Shërbime në fushën e ndërtimit dhe rikonstruksionit; Shërbime në fushën e hoteleri- turizëm;



Shërbime në fushën e agroturizmit dhe agroindustri; Konsulencë për investime në industrinë e mallrave ushqimorë, si dhe cdo veprimtari tjetër që nuk ndalohet me ligjin në fuqi të shtetit Shqiptar.

**Neni 3:**

**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pacaktuar.

**Neni 4:**

**Selia**

(1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Kompleksi “Olympic Residence”, Ap. 5, Hyrja 1, Kati 2, “Rruga Liman Kaba”, Tirane.

(2) Shoqëria mund të hapë filiale, dege, perfaqesi, agjensi etj në Shqipëri si dhe në cdo shtet të huaj, me miratimin e Asamblese së Përgjithshme dhe në përputhje me ligjet e vendit apo shtetit përkatës ku ato do të hapen.

**KREU II**

**KAPITALI**

**Neni 5**

**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 10.000,00 (dhjetë mijë) Lekë, i përbërë nga një kuote, e cila përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërisë.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

Ortaku i vetëm themelues **Jerina Kume**, zotëruese e 1 (një) kuote kapitali me vlerë të përgjithshme 10.000,00 leke që përben **100%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

**Neni 6:**

**ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe/ose me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emerimit nga gjykata

kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

## **Neni 7**

### **TRANSFERIMI I KAPITALIT**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## **KREU III**

### **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

## **Neni 8**

### **ORGANI VENDIMMARRES**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj

pike;

dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Ne rast se shoqëria ka vetëm një ortaK, atehere Asambleja e Ortakeve perbehet nga ortaku i vetem.

## Neni 9

### MËNYRA E THIRRJES SE MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## Neni 10

### KUORUMI

Per cdo vendimmarrje, pervec rasteve qe ligji kerkon domosdoshmerisht nje shumice te caktuar, asambleja e zakonshme ose e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë **te pakten 75% të kuotave**.

Nëse asambleja nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite, pasi të sigurohet se njoftimi i ortakëve është bere dhe ka mbërritur ne destinacion, ne te kundert mbledhja dhe cdo vendimmarrje eshte ne kundërshtim me ligjin dhe kete akt themelimi dhe statut.

## Neni 11

## **MARRJA E VENDIMEVE**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, si dhe për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- g) autorizimin e një ose disa personave për kryerjen e veprimeve të ndryshme financiare apo juridike në emer dhe për llogari të shoqërisë.

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

### **Neni 12**

#### **PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTËS**

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### **Neni 13**

#### **ADMINISTRIMI**

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të shoqërisë me afat për 5 vjet me të drejtë ripërtëritjeje nga regjistrimi në QKB:

Të dhënat e identifikimit:

dhe specimenët e nënshkrimit:

1. **Jerina Kume**, me shtetesi Shqiptare, lindur me 19.01.1990 ne Berat, identifikuar me leternjoftim me nr. personal J05119072V, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.



nenshkrimi

(4) Per cdo veprim administrimi, dy administratoret do te nenshkruajne njekohesisht ne menyre qe vendimi te jete I vlefshem. Secili admnistrator mund te autorizoje nje person te trete ose administratorin tjeter, me ane te prokures noteriale, per te kryer veprime te caktuara ose te pergjithshme.

(5) Administratoret do te kryejne cdo veprim administrimi qe ka te beje me veprimet bankare. Cdo blerje, shitje si dhe cdo veprim tjeter ne kompetence te tyre do te kryhet nga ata vete. Administratoret mund te autorizojne nje person per te kryer veprimet prane organeve kompetente shteterore per pagimin e taksave dhe tatimeve te shoqerise.

#### **KREU IV**

#### **FINANCIMI, KONTROLLI KONTABEL, BILANCI, FITIMI**

##### **Neni 14**

##### **KONTROLLI KONTABEL**

Kontrolli i jashtem kontabel i shoqerise do e kryhet nga eksperte kontabel te autorizuar sipas ligjit ne fuqi. Asambleja e ortakeve do te emeroje nje apo me shume eksperte kontabel ne ao raste kur emerimi i tyre konsiderohet i nevojshem ose kerkohet ne baze te ligjit.

##### **Neni 15**

##### **FINANCIMI I SHOQERISE**

Administrarori/administratoret e shoqerise kane te drejte te kerkojne nga Asambleja e Ortakeve miratimin e financimeve per aritjen e objektiveve te shoqerise, te ndryshme nga zmadhimi i kapitalit themeltar te shoqerise, duke parashtruar te gjithë argumentin teknik dhe analizen e performances dhe efektivitetin e propozimit te bere per financimin e shoqerise.

Financimet e metejshme do te behen prej ortakeve te saj apo pesonave te trete, me apo pa shperblim (ineresa), ne varesi te titullit nepermjet te cilit jepen keto fonde dhe do te jene te vlefshme vetem ne rast te miratimit te tyre me specifikat perkatese me shumicen prej 75% te te gjitha kuotave te shoqerise.

Asambleja ka te drejte te vendosi ne cdo kohe lidhur me rezervat dhe sasine e tyre me miratimin me 75% te te gjitha kuotave te shoqerise.



## **Neni 16**

### **VITI FINANCIAR**

Viti financiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe mbaron me date 31 Dhjetor te cdo viti, pervec vitit te pare, i cili fillon nga data e regjistrimit dhe mbaron ne fund te vitit.

## **Neni 17**

### **LLOGARITE VJETORE**

Llogarite vjetore, raporte mbi operacionet e veprimtarise lidhur m vitin financiar dhe raportet e vecuara te hartuara nga administratori dhe nga eksperti kontabel i autorizuar, miratohen brenda 6 muajve nga dita e mbylljes se vitit financiar, nga asambleja me shumicen e 75% te te gjitha kuotave.

## **Neni 18**

### **FITIMI**

Te ardhurat neto, pas vecimit te fondeve si me siper dhe shlyerjes se detyrimeve fiskale i mbesin per perdorim ortakeve te shoqerise te cilet i ndajne midis tyre ne perputhje me kuotat e secilit ne raport me kapitalin themeltar te shoqerise.

Fitimet e shoqerise do te merren ne shqyrtim per tu ndare ne formen e dividendit ndermjet ortakeve pasi te jene shlyer huamarrjet nga shoqeria prej ortakeve dhe te miratuara nga asambleja me 75 % te te gjitha kuotave te shoqerise.

Ne te gjitha rastet dhe ne fund te cdo lloj periudhe ushtrimore, nese shoqeria rezulton me fitime te vitit ushtrimor dhe ne te njejten kohe rezulton me fitime te pashlyera, ne reference te pikes se mesiperme, detyrohet qe fitimin e realizuar deri ne vleren e huase se mbetur ende pa shlyer, ta paguaje ne drejtim te ortakeve te saj ne raport me gjendjen e pashlyer te huase dhe me specifikat e marreveshjes se tyre. Per kete qellim administratori/administratorete jane te detyruar per ekzekutimin e ketij detyrimi ne momentin me te pare te mundshem dhe brenda dates 31 Mars te vitit pasardhes ushtrimor duke e konsideruar kete statut si titull ekzekutiv.

Fitimet e shoqerise ndahen ne formen e dividendeve midis ortakeve pasi eshte mbajtur dhe tatimi perkates mbi dividendin.

Vendimi per caktimin e fitimeve (per shperndarjen e fitimeve, per caktimin e rezervave apo mosshperndarjen e fitimeve te vitit ushtrimor apo edhe fitimeve te mbartura) do te merret ne mbledhjen e asamblese se ortakeve te shoqerise me miratimin nga 75% te te gjithe ortakeve te shoqerise.

## **Neni 19**

### **BILANCI**

Veprimtarite ekonomike dhe financiare te shoqerise mbyllen ne 31 Dhjetor te cdo viti.

Administratori/administratorete e shoqerise nxjerr bilancin kontabel dhe aportin perkates ne perputhje me dispoziten ligjore per kontabilitetin.

Raporti i administrimit, inventaret, bilancet dhe llogarite vjetore te hartuara I nenshtrohen pa perjashtim

miratimit te asamblese se ortakeve me shumice 75% te te gjitha kuotave.

Me miratimin e bilancit kontabel, shoqeria vendos per fondet e nevojshme per zhvllimin si psh. Fondi rezerve, ai I akumulimi, investimit etj.

## **KREU V**

### **PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE**

#### **Neni 20**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak si:

- Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhimit te metejshe te veprimtarise se saj.
- Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji per falimentimin e shoerive tregtare. Etj.

Ne kete rast asambleja e ortakeve merr vendim duke caktuar nje ose disa likuidatore dhe duke shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej saj emrin e lkuidatorit dhe emertesenshtese "Shoqeri ne likuidim e siper".

Shoqeria duhet te kryeje procesin e likuidimit ne perputhje m eligjet ne fuqi te RSH.

Afati i emerimit te likuidatoreve publikohet sipas kushteve e parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen depozituar ne Aneksin e Regjistrimit Tregtar prane QKB.

### **DISPOZITA PERFUNDIMTARE**

#### **Neni 21**

Te gjitha mosmarreshjet brenda shoqerise qe mund te lindin gjate ekzistences se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, do te shqyrtohen nga Gjykata e Rrethit Tirane.

#### **Neni 22**

Ky statut mund te ndryshohet me vendimin e asamblese se ortakeve, ne perputhje me percaktimet e ligjit 9901/2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" I ndryshuar dhe aktet e tjera ligjore dhe nenligjore ne fuqi.

Cdo ndryshim ne kete statut, nuk e prek personalitetin juridik te shoqerise.

#### **Neni 23**

Ky statut u redaktua ne 5 ekzemplare me permbajtje dhe vlere te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim nga dhe nen per nen nga ortaket themelues te shoqerise nenshkruhet ne te gjitha kopjet dke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tyre origjinale, autenticiteti i te cilave vertetohet nga Noteri.

**ORTAKE:**

1. **Jerina Kume**, me shtetesi Shqiptare, lindur me 19.01.1990 ne Berat, identifikuar me leternjoftim me nr. personal J05119072V, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Jerina Kume 